



Gjatë kursit mësohet krijimi i faqeve të me gjuhën HTML dhe CSS. Kjo gjuhë është bazë e kodit për të gjitha gjuhët tjera të uebit, prandaj ky kurs është i përshtatshme jo vetëm për fillestarë, por edhe programues profesional me të gjitha shkallëve të diturisë. Stilet përdoren njësoj edhe për PHP ose ASP.

Kusht i domosdoshëm për pjesëmarrës është dituria e mjaftueshme e gjuhës HTML ose përvoja me programe për krijimin e kodit të gatshëm: për shembull Dreamweaver, Homesite, GoLive, etj.

Ky kurs mund të kombinohet me kursin tonë tjetër për HTML. Me këto dy kurse pjesëmarrësi ka dituri të mjaftueshme për krijimin e pamjes së faqeve profesionale me programe plotësisht falas.

Hyrje

- Formatimi klasik me HTML
- Çka janë stilet CSS
- Përparësitë e stileve CSS
- Përkrahja nga shfletuesit

Vetitë e tabelës dhe qelizave të tabelës

- Hapësira, rrethi dhe margjina
- Drejtvendosja horizontale dhe vertikale
- Hapësira dhe margjina

Llojet e stileve dhe zbatimi

- Llojet e stileve dhe si punojnë ato
- Stili rendor, i faqes dhe qendror
- Sintaksa e stileve
- Krijimi i stilit rendor
- Krijimi i stilit për etiketa të HTML-it
- Krijimi i klasës
- Krijimi i stilit për elementet me ID
- Grupimi i stileve
- Zbatimi i stilit të krijuar

Vetitë e shtresës

- Hapësira dhe margjina
- Krijimi i pamjes me shtylla të përmbajtjes me ndihmën e shtresave

Krijimi i stileve sipas mjetit të përdorimit

- Krijimi i stileve për të njëjtën faqe për tregim në ekran, për shtypje ose për ekran të telefonit celular dhe për vizitorë me aftësi të kufizuara.

Formatimi i tekstit, kokrrat dhe numërimi

- Lloji i shkronjave
- Madhësia dhe mjetet matëse
- Ngjyra e tekstit
- Lartësia e rreshtit
- Trashësia dhe pjerrësia
- Drejtvendosja
- Dekorimi i tekstit
- Kokrrat, numërimi dhe pamja e tyre

Krijimi i pamjes së plotë të faqes së uebit

- Ushtrime praktike për krijimin e pamjes së plotë të sajtit me HTML dhe CSS nga vetëm një dokument qendror.
- Ushtrime me të gjitha vetitë e stileve
- Krijimi i menysë së shfletimit nga kokrrat e etiketave HTML

Gjatë kursit pjesëmarrësit ushtrojnë me detyra praktike. Të gjithë pjesëmarrësit kanë të drejtë përkrahje pa pagesë përmes postës elektronike.

Librat, tani për tani, janë anglisht ose holandisht, por detyrat dhe ushtrimet janë shqip.

Për hollësi kontaktoni në adresën info@studiotuerta.com ose vizitoni sajtin www.studiotuerta.com.